



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 25.06.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **24.06.2025**, të parashtruar nga GOE GEOPLAN CONSULTING & STUDIO HAPSIRA SHPK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Mbikëqyrja e punëve në projektin e renovimit të Depos së Barnave dhe ndërtimit të aneksit”** me nr. prokurimi 206-25-5491-2-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e GOE GEOPLAN CONSULTING & STUDIO HAPSIRA SHPK e dt. 24.06.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Mbikëqyrja e punëve në projektin e renovimit të Depos së Barnave dhe ndërtimit të aneksit”** me nr. prokurimi 206-25-5491-2-2-1, kundër Njoftimit për kontratë të datës 18.06.2025;
2. **Vërtetohet**, Njoftimi për kontratë i datës 18.06.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

GOE GEOPLAN CONSULTING & STUDIO HAPSIRA SHPK me datën 24.06.2025, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Mbikëqyrja e punëve në projektin e renovimit të Depos së Barnave dhe ndërtimit të aneksit”** me nr. prokurimi 206-25-5491-2-2-1. Autoriteti Kontraktues me datë 25.06.2025 e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

NENI 7 : Barazia në trajtim / jo-diskriminimi.

NENI 56 : Dizpozita e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave .

RRUOPP (Rregullat dhe Udhëzuesi Operativë i Prokurimit Publikë)

Pretendimet ankimore te OE ankues:

Pas shqyrtimi i dosjes tenderit 651-24-8114-2-1-1, Nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Shëndetësisë kemi konstatuar që ka pregaditur specifika të panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit duke eliminuar Konkurencën

Bazuar në Kërkesat e Përshtatsh mërisë profesionale dhe teknike :

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
Kërkesa 1. OE ose GOE duhet të dëshmoj se ka përfunduar me sukses shërbime te ngjashme (projekte, mbikëqyrje) ne tri vitet e fundit nga data e njoftimit për kontrate në vlerë prej 45,000,000 Euro. Të paktën një projekt nga sektori i shëndetësisë.	Dëshmia 1. - Një listë të kontratave të realizuara gjatë tri viteve te fundit nga data e njoftimit për kontrate, duke saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit, datën e përfundimit, të dhënat e personit kontaktues dhe përfituesin. Lista te jete ne origjinal, e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Listës ti bashkëngjiten Referencat ose Certifikatat e pranimit te shërbimeve.
Kërkesa 2. Operatori Ekonomik duhet të dëshmoj minimumin e kapacitetit të stafit profesional të nevojshëm të kompanisë sipas profileve ne vijim 2.1 Një Inxhinier i Arkitekturës i Licencuar nga OAK (sistemi 5 vjeçar ose master) me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit. 2.2 Një Inxhinier i Ndërtimtarisë drejtimi Konstruktiv, i Licencuar nga OIK (sistemi 5 vjeçar ose master) me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit. 2.3 Një Inxhinier i Ndërtimtarisë drejtimi Hidroteknikë, i Licencuar nga OIK (sistemi 5 vjeçar ose master) me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit. 2.4 Një Inxhinier i Elektroteknikës, i Licencuar nga OIK (sistemi 5 vjeçar ose master) me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit. 2.5 Një Inxhinier i Makinerisë, i Licencuar nga OIK (sistemi 5 vjeçar ose master) me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit. 2.6 Një Inxhinier për menaxhimin e emergjencave; - Njeri nga inxhinieret e ndërtimtarisë Konstruktiv ose Hidro (2.2 ose 2.3) duhet te jete i certifikuar për menaxhimin e kantierit te ndërtimit. - Se paku dy prej gjashtë inxhinierëve te kërkuar, duhet te jenë te certifikuar si Auditor te Energjisë në Ndërtesa, me certifikata nga institucioni përkatës-Universiteti i RK	Dëshmia 2. - Lista e Stafit Profesional e nënshkruar dhe vulosur, nga origjinal. - CV e përvojës së punës, e nënshkruar nga vete inxhinieret - Kopje te diplomave; - Kopje te certifikatave te kërkuara; - Referencat e punës; - Lista e ATK-se me kontributet e realizuara se paku ne tre muajt e fundit nga Njoftimi për kontratë; - Për njërin nga inxhinieret e ndërtimtarisë Konstruktiv ose Hidro (2.2 ose 2.3) kërkohet kopja e certifikatës ISO për menaxhimin e kantierit te ndërtimit. - Për dy prej gjashtë inxhinierëve te kërkuar, kërkohet kopja e certifikatës si Auditor te Energjisë në Ndërtesa, nga institucioni përkatës-Universiteti i RK.

TË LARGOHET LISTA E ATK-SË ME KONTRIBUTET E REALIZUARA 3 MUAJ E FUNDIT NGA NJOFTIMI PËR KONTRATËS , PASI ZVOGLON KONKURENCËN DHE PJESËMARRJEN NË KËTË TENDER.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues në lidhje me pretendimet ankimore:

E kemi shqyrtuar Kërkesën tuaj për rishqyrtim dhe mund të konstatojmë se pretendimi juaj është i pa bazuar.

Duke marrë parasysh rëndësinë e projektit, është e rëndësishme që OE të ketë staf profesional inxhinierik permanent, e jo të ofertoj me marrëveshje për angazhim për këtë projekt, meqenëse bazuar në përvojën paraprake të AK, marrëveshje të tilla shpesh herë nuk zbatohen gjatë implementimit të kontratës dhe stafi i ofruar në oferte nuk po ofrohet pastaj edhe në punishte.

Bazuar në sqarimet e lartcekura, AK-MSh e konsideron të arsyeshme kërkesën që për stafin profesional, krahas dëshmive tjera kërkohet edhe: – **Lista e ATK-se me kontributet e realizuara se paku në tre muajt e fundit nga Njoftimi për kontratë;**

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi të këtij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit